



Në përputhje me Ligjin për sistemin e kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik, kryetari i Komunës së Bogovinës sjell:

KODI ETIK I KOMUNËS SË BOGOVINËS

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i Kodit

Ky Kod synon të forcojë integritetin institucional, transparencën, efikasitetin, dhe përgjegjësinë në administratën komunale. Ai shërben si udhëzues për sjellje profesionale dhe etike për të gjithë të punësuarit.

Neni 2

Fusha e Zbatimit

Kodi vlen për:

- Të punësuarit në administratën komunale;
- Zyrtarët e zgjedhur lokalë;
- Të gjithë punonjësit e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve në varësi të komunës.

Neni 3

Baza Ligjore dhe Normative

Kodi mbështetet në:

- Ligjin për Kontrollin e Brendshëm Financiar;
- Ligjin për Nëpunësit Administrativë;
- Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit;
- Strategjitë nacionale për etikë dhe transparencë në sektorin publik.

KREU II

PARIME TË PËRGJITHSHME ETIKE

Neni 4

Integriteti Personal dhe Institucional

Secili i punësuar ka detyrimin të sillet me ndershmëri, paanshmëri dhe profesionalizëm, duke mbrojtur interesin publik mbi atë personal.

Neni 5

Objektiviteti në Vendimmarrje

Vendimet duhet të merren mbi bazën e fakteve, të drejtës dhe pa ndikime nga jashtë (politikë, interesa personale apo presion shoqëror).

Neni 6

Barazia dhe Paanshmëria

Shërbimet duhet të ofrohen në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, pa diskriminim për asnjë bazë.

Neni 7

Llogaridhënia dhe Transparenca

Çdo veprim i ndërmarrë duhet të jetë i justifikueshëm, i dokumentuar dhe i hapur për shqyrtim publik.

Neni 8

Profesionalizmi dhe Kompetenca

Të punësuarit kanë për detyrë të përditësojnë njohuritë profesionale dhe të kryejnë detyrat në përputhje me standardet më të larta të cilësisë.

KREU III

ETIKA FINANCIARE DHE KONTROLI I BRENDSHËM

Neni 9

Menaxhimi i Pasurive dhe Burimeve Publike

Pasuritë e komunës duhet të përdoren vetëm për qëllime zyrtare. Keqpërdorimi i resurseve për qëllime personale ndalohet rreptësisht.

Neni 10

Respektimi i Procedurave Buxhetore dhe Prokurimit

Të gjitha shpenzimet duhet të jenë të arsyetuara dhe të kryhen në përputhje me rregullat ligjore të prokurimit publik.

Neni 11

Kontrolli i Brendshëm dhe Roli i revizionit

Administrata është e detyruar të bashkëpunojë plotësisht me njësitë e revizionit të brendshëm , duke garantuar qasje në dokumentacion dhe duke zbatuar rekomandimet.

Neni 12

Parandalimi i Mashtrimeve dhe Korrupsionit

Të gjitha veprimet e dyshimta duhet të raportohen dhe të hetohen.

KREU IV

SJELLJA NË VENDIN E PUNËS

Neni 13

Marrëdhëniet Ndërpersonale

Të punësuarit duhet të respektojnë kolegët dhe të krijojnë një ambient pune pozitiv, pa mobing, ngacmime apo përjashtime.

Neni 14

Respekti Ndaj Qytetarëve

Qytetarët duhet të trajtohen me durim, mirëkuptim dhe profesionalizëm. Ndalohet arroganca dhe sjellja e papershtatshme ndaj tyre.

Neni 15

Përdorimi i Teknologjisë dhe Komunikimit

Email-i zyrtar, pajisjet dhe rrjetet komunale duhet të përdoren vetëm për qëllime pune. Postimet në rrjetet sociale nuk duhet të dëmtojnë imazhin e institucionit.

Neni 16

Konfidencialiteti dhe Ruajtja e Informacionit

Informacionet që punonjësit marrin në kuadër të detyrës janë konfidenciale dhe nuk duhet të shpërndahen pa autorizim.

KREU V

KONFLIKTI I INTERESIT DHE SINJALIZIMI

Neni 17

Identifikimi dhe Deklarimi i Konfliktit të Interesit

Çdo punonjës që ndodhet në situatë ku interesat private mund të ndikojnë në ushtrimin e detyrës duhet të njoftojë udhëheqësinë.

Neni 18

Transparenca dhe Deklarimi i Pasurisë

Zyrtarët janë të detyruar të deklarojnë pasurinë në mënyrë të plotë dhe në afatet e përcaktuara ligjore.

Neni 19

Mbrojtja e Sinjalizuesve

Çdo person që sinjalizon në mirëbesim shkeljet ligjore ose etike gëzon mbrojtje nga ndëshkimi ose hakmarrja.

Neni 20

Politika Kundër Ndëshkimit

Asnjë punonjës nuk duhet të ndëshkohet për raportim të shkeljeve, përfshirë raportimin anonim të bazuar në prova.

KREU VI

ZBATIMI, EDUKIMI DHE MASAT DISCIPLINORE

Neni 21

Komisioni i Etikës

Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë rastet e shkeljeve, të japë udhëzime për zbatim dhe të propozojë masa korrigjuese.

Neni 22

Edukimi i Vazhdueshëm Etik

Komuna do të organizojë trajnime periodike për etikën, qeverisjen e mirë, konfliktin e interesit dhe kontrollin financiar.

Neni 23

Shkeljet dhe Sanksionet

Shkeljet e rënda të këtij Kodi mund të çojnë në:

- Vërejtje me shkrim;
- Pezullim të përkohshëm;
- Largim nga puna;
- Njoftim të organeve kompetente për hetim penal.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Mbikëqyrja dhe Raportimi

Komisioni për Etikë përpilojnë një raport vjetor për zbatimin e Kodit dhe i propozojnë Këshillit masa për përmirësim.

Neni 25

Rishikimi i Kodit

Kodi rishikohet çdo tre vjet ose më shpesh nëse ka ndryshime ligjore ose rekomandime nga institucionet mbikëqyrëse.

Бр / Nr. 08-1127/1

07.05.2025 год / vit

Општина Боговиње / Komuna e Bogovinës
Градоначалник / Kryetar

Бесник Емши / Besnik Emshi

